



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi Received / Delivery	14-04-2021	1	viti god year
Organ / Njësia Org / Jednica Org / Unit	SKOPSHTAK	1784/2021	114
Nr Prot Br Prot Prot No		Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.188/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.3068/19 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.614/2019 të datës 09.10.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë Banimi Rr. "Vehbi Ibrahim" Nr.18, Lagjja Zabel, Komuna e Gjilanit, kundër Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Detyrohet Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë shqyrtimin e kërkesës me numër protokoli 10 të datës 24.07.2019 të parashtruar nga ankuesi
- II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 09.10.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 4716/2019 e regjistruar me A.nr.614/2019 të datës 09.10.2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor se duhet t'i pranohet kontributi i meritës dhe autorësisë së zyrës shtesë në DKR pranë Agjencisë Pyjore të Kosovës në Gjilan.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.10.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoli 4870/2019 të Agjencia Pyjore e Kosovës. Ndërsa me datë 21.10.2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokoli 4954/2019 se bashku me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me ç'rast Këshilli me shkresën e datës 20.11.2019 ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së tij me numër A.nr.614/2019 të datës 09.10.2019, duke udhëzuar ankuesin mbi të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.3068/19 të datës 23.03.2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar Njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 20.11.2019 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 09.10.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 09.10.2019 me numër protokoli 4716/2019 të parashtruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit të datës 31.02.2012 me numër ZP-83/2012; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 01.12.2008 me numër:01/2008; Formularin e Regjistrimit të ankesës së ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Kërkesën e datës 10.05.2019 me numër SBNJH-206/19 për ri-shqyrtimin e vlerësimit të rezultateve në punë të vitit 2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 të datës 24.12.2018; E-mailin e datës 29.12.2018 dërguar nga ankuesi për _____ me e-maillet e bashkangjitura të datës 01.10.2018; Kërkesën e datës 28.12.2018 për rishqyrtimin e rezultateve në punë të vitit 2018; Emailin e datës 29.12.2018 dërguar nga ankuesi për _____ me e-maillet e bashkangjitura; Njoftimin e datës 13.12.2018; Shkresën e titulluar Lënda: Akt Përcjellës; E-mailin e datës 13.12.2018 dërguar nga ankuesi për _____ Kërkesën e datës 26.11.2018 me numër REF.GJIO/APK: 208/2018; E-mailin e datës 26.11.2018 dërguar nga ankuesi për _____ Shkresën e titulluar Lënda: Akt Përcjellës; faqe 02 nga 02; Kërkesën e datës 24.07.2019 me numër:10 për pranimin e kontributit si meritë në autorësinë e zyrës shtesë në drejtori; Kërkesën e datës 25.01.2019 me numër SBNJH-53/2019 më përmbajtje në 5 (tre) faqe; Kërkesën e datës 29.05.2019 me numër Ref:322/19 dërguar për _____ Kërkesën e datës 29.05.2019 me numër Ref:322/19 dërguar për _____ Ankesën e plotësuar e datës 10.10.2019 me numër protokoli:4733/2019 me e-maillet e datës 08.10.2019 dhe 09.10.2019 me 5 (pesë) faqe të bashkangjitura; Njoftimin e datës 26.11.2018 me shkresat e bashkangjitura prej 3 (tre) faqesh; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.10.2019; Përgjigjen në ankesë të datës 21.10.2019; Përshkrimin e detyrave të a punës për ankuesin; E-mailin e datës 17.10.2019 dërguar nga _____ për _____ Emailin e datës 17.10.2019 dërguar nga _____ për _____ Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative numër A.nr. 3068/19 të datës 12.03.2021; Emailin e ankuesit të datës 29.03.2021 dërguar në adresën elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net me numër protokoli:1463/2021 me shkresat e bashkangjitura prej dhjetë (10) faqesh.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës ka konstatuar që lënda të kthehet në detyrim të organi i punësimit për shqyrtimin e kërkesës së ankuesit _____ me numër protokoli 10 të datës 24.07.2019, *sepse* :

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimit ZP-83/2012 të datës 31.01.2012, Kolegji ka gjen se ankuesi është i sistemuar në pozitën Zyrtar për Çështje Ekonomike në Drejtorinë Koordinues në Gjilan, pranë Agjencisë së Pyjeve të Kosovës.

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesi pretendon se përkundër kërkesave të shumta të

adresuar tek Udhëheqësi i drejtpërdrejt, Menaxheri i Personelit si dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Pyjeve, asnjëherë nuk është iniciuar procedura e pranimit të autorësisë për Zyrën shtesë në DKR në Gjilan. Me tutje shton se kjo e drejtë i njihet bazuar në Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe propozon që Këshilli ti pranoj ligjërisht autorësinë e Zyrës shtesë në DKR në Gjilan.


Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi disa herë radhazi ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit më bazë të njëjtë si në ankesë dhe atë: Kërkesa për rishqyrtim drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv të APK-së përmes e-mailit të datës 01.10.2018, Njoftim-kërkesa drejtuar Menaxheres së Personelit dhe Udhëheqësit të Sektorit Ligjor të APK-së përmes e-mailit të datës 29.10.2018, Njoftim-kërkesa e datës 13.12.2018 drejtuar Menaxheres së Personelit të APK-së, Njoftim ref.GJI/APK 208/2018 i datës 26.11.2018 drejtuar Drejtorit të Drejtorisë Koordinuese në Gjilan, Kërkesa e datës 28.12.2018 drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv të APK-së përmes emailit të datës 29.12.2018, Kërkesa SBNJH-53/19 e datës 25.01.2019 drejtuar Zyrës së Personelit të APK-së, Kërkesa SBNJH-206/19 e datës 10.05.2019 drejtuar Zyrës së Personelit të APK-së, Kërkesë NR. 322/2019 përmes e-mailit me datë 29.05.2019 drejtuar Drejtorit të Drejtorisë Koordinuese në Gjilan, Kërkesë NR. 32/2019 përmes emailit me datë 29.05.2019 drejtuar Drejtorit të Drejtorisë Koordinuese në Gjilan dhe Kërkesa Nr. 10 e datës 24.07.2019 drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv të APK-së.

Po ashtu nga vlerësimi i provave të lëndës, Kolegji nuk vëren ndonjë shkresë që dëshmon se organi i punësimit ka iniciuar procedurë të shqyrtimit të kërkesës së përsëritur ankuesit si dhe nuk ka ofruar ndonjë përgjigje për ankuesin në lidhje me kërkesat e tij. Ndërlidhur me këtë fakt, në përgjigjen në ankesë organi i punësimit deklaroi se ankuesi asnjëherë nuk ka bërë ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë e Pyetjeve të Kosovës dhe se nuk ka pas ndonjë aktmarrëveshje me punëdhënësi për angazhim në punë shtesë.

Bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, me të cilin pretendon se i janë cenuar të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 127 paragrafi 2 ka përcaktuar se: "Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", dhe si rrjedhojë Kolegji duke nisur nga kërkesa e fundit e ankuesit e parashtruar të Kryeshefi Ekzekutiv i APK-së me datë 24.07.2019, konstaton se ankesa është parashtruar në Këshillë me datë 09.10.2019 është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në vështrim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenit 83, 86, 96 dhe 97, Kolegji vlerëson se një procedurë administrative mund të fillojë me kërkesë të palës dhe se organi publik të cilit i është drejtuar kërkesa do të shqyrtojë dhe vlerësojë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative të iniciuar me kërkesë si dhe të përfundojë procedurën administrative me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative.

Ndërlidhur me afatet e përfundimit të një procedurë administrative Neni 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat,*



siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.

Andaj, në kuptim të dispozitave si me lartë si dhe duke pas parasysh gjendjen faktike të konstatuar si me sipër, Kolegji konstaton së Agjencia e Pyjeve të Kosovës në cilësi të organit të punësimit ka qenë e obliguar të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me kërkesën e përsëritur të ankuesit për njohje të së drejtës së pretenduar.

Kështu që, bazuar në rrethanat si më lartë, Kryeshefi Ekzekutiv i APK-së është i obliguar që brenda afatit si në dispozitiv të këtij vendimi, të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 24.07.2019 me numër protokollit 10, si dhe me rastin e shqyrtimit të merr parasysh të gjeturat dhe rekomandimet sipas këtij vendimi.

Bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me A.nr.188/2021

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

